



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:003485

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731865

Ac.nr.3171/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Naim Mehulli, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.D. nga fsh....., Komuna e I....., të cilin e përfaqëson Luljeta Jashari – Hertica, avokate nga Prishtina, sipas autorizimit, kundër të paditurës, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, me seli në Komunë e Prishtinës, të cilën e përfaqëson Muharrem Kurtaj, nga Avokatura Shtetërore, sipas autorizimit, me bazën juridike, anulim i vendimit dhe kthim në punë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.15/20, i datës 30.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pathemelta ankesa e paditësit D.D. nga fsh....., Komuna e I....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.15/20, i datës 30.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.15/20, i datës 30.03.2021, është vendosur që të: **HEDHET** poshtë padia e paditësit, D.D. nga fsh....., Komuna e I....., e datës, 25.07.2015, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë i Kosovës me nr. 19 i datës, 28.02.2008, me të cilin vendim paditësit i është shqiptuar masa disiplinore, ndërprerje e marrëdhënies së punës, si i kundërligjshëm, dhe detyrohet e paditura Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, që paditësit D.D. nga fsh., I....., ta kthejë në vendin e punës si Oficer Korrektues në Pavijonin nr. 1, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, si dhe shpenzimet e procedurës e krejt këtë në afat prej 8 ditësh nga plotfuqishmëria, nën kërcënimin të përmbarimit, **SI E PASAFATSHME**.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi e autorizuar e paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur pa i specifikuar shkaqet e ankimit, me propozim që

Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën dhe aktvendimin e atakuar ta ndryshojë si në propozim të kësaj ankese.

Përgjigje në ankes nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 13.07.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur ankesë, padi, kundër të paditurës, lidhur me kontestin e punës, anulimin e vendimit të Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës të datës 28.02.2008, dhe kthim në vendin e punës.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.176/15, i datës 21.01.2016, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr. 773/16, i datës, 04.12.2019, është aprovuar si e themelet ankesa e të paditurës Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me seli në Prishtinë, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Istog, C.nr. 176/15 i datës 21.01.2016, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim me vërejtje dhe sugjerime si në aktvendim.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktvendim e atakuar C.nr.15/20, i datës 30.03.2021 me të cilin e ka hedhur posht si të pasafatshe padinë e paditësit më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimituar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata konstaton se në çështjen konkrete zbatim gjeni Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës i aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, me dt. 28.09.1989. Duke u bazuar në nenin, 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës i aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, me dt. 28.09.1989, (ligj i aplikueshëm në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësit me datën, 28.02.2008), (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr.60/89) ligj ky që ka qenë i aplikueshëm në Kosovë në bazë të rregullores së UNMIK-ut 1999/24 (me këtë rregullore janë përcaktuar ligjet që janë në fuqi në Kosovë), kërkesa e paditësit për kthim në vendin e punës është e pasafatshme. Kjo për faktin se neni 83 i ligjit të lartpërmendur përcakton që “ ***Punëtori i pakënaqur me vendim definitiv të organit kompetent në organizatë, apo nëse ky organ nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, gjegjësisht kundërshtimit, ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente***”. Në kuptim të afatit që përcaktohet me këtë dispozitë rrjedh se padia e paditësit për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për kthim në vendin e punës në gjykatë e ka paraqitur me datë, 13.07.2015, ndërsa paditësi nga vendi i punës ishte larguar sipas vendimit të Komisionit Disiplinor nga Ministria e Drejtësisë me nr. të rastit. 19 i datës: 28.02.2008, i cili vendim ishte vendim ishte vërtetuar nga ana e Komisionit të Ankesave nga Ministria e Drejtësisë, me Nr. KA/029/2008, i datës 29.04.2008, ndërsa me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, i është aprovuar pjesërisht ankesa me nr. 02(161)08 ndërsa Ex-Officio anulohet vendimi i Komisionit Disiplinor

nr. 19 i datës 28.02.2008, dhe Vendimin i Komisionit të Ankesave të MD- së, nr. KA/029/2008 i dt.29.04.2008, çështja i kthehet në rishqyrtim në shkallë të parë. Ndërsa me Vendimin me numër të protokollit Nr. 115 i dt. 18.07.2008, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, duke vepruar sipas Vendimit të KPMK-së nr. 02(161)2008, të datës, 23.06.2008, D.D. , këtu paditësit oficer korrektues në pavijonin Nr.1 në Dubravë i ka shqiptuar masën disiplinore Ndërprerja e punës, përfundimisht me datën. 29.02.2008, nga shkresat e lëndës konstatohet se Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datën, 23.06.2015, i është përgjigjur në kërkesë e datës, 09.06.2015 , nr. protokollit 0653, me të cilën përgjigje është njoftuar se Komisioni Disiplinor i shërbimit Korrektues të Kosovës i datës, 18.07.2008, nr. protokollit 115 ka nxjerre vendim përfundimtarë me të cilin ju ka shqiptuar masën disiplinore Ndërprerja në marrëdhënies të punës, kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankesa në afatin ligjor. vendimi për shqiptimin e masës disiplinore është i plotfuqishme me procedurën administrative duke marr parasysh se ndaj këtij vendimi nuk është iniciuar as konteste punë në gjykatën kompetente.

Tutje gjykata ka shtuar se duke marrë për bazë vendimin mbi ndërprerjen e mardhenjës së punës përfundimisht me numër të rastit, Protokollit nr. 115 i datës 18.07.2008, i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë, pasi që nga përshkrimi i padisë rezulton së kundër vendim për ndërprerjen e mardhenjës së punës nuk ka provuar se ka ushtruar ankesë pranë paditurës, ndërsa padinë e ka ushtruar me datën, 13.07.2015, çka në rastin konkretë paditësi nuk ka ushtruar të drejtën e ankesës-pra nuk i ka shtjerr mjetet e brendshme pranë punëdhënësit-këtu të paditurës, dhe duke e lëshuar afatin për ushtrimin e padisë, gjegjësisht mbrojtjen e të drejtave të tij pranë gjykatës dhe atë, afatin prej 15 dite, nga dita kur është dashur ushtruar ankesa, gjegjësisht 8 dite, kur organi i shkallës së dytë të paditurës është dashur të vendos mbi ankesën e paditësit, dhe mos vendosja e organit të shkallës së dytë, lidhur me ankesën e paditësit në afat prej 8 dite, nënkupton se ankesa e paditësit është refuzuar. Në rastin konkret paditësi, padinë e ka ushtruar pranë kësaj gjykate me më shumë se, 7 vite, nga dita kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës përfundimisht, çka nënkupton se padia e tij kundër të paditurës është e pas afatshme, për çka gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi. Për këtë rrethanë me dispozitën e nenit, 391 pika (f) e LPK-së, parashihet se : Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se : pika (f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj, e që në rastin konkret e paditura me përgjigje në padi por edhe në seancë është thirrur në paafatshmeri e padisë së paditësit.

Ne fund gjykata e shkalles së par ka theksuar se me rastin e vendosjes morri në konsideratë edhe pretendimet e të autorizuarës se paditësit sa i përket të drejtës materiale respektivisht potencomi të dispozitave të Ligjit mbi Shërbyesit Civil nr.03/-149 i datës 13.05.2010,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës dt. 25.06.2010), një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar, pasi vendimi i Komisionit Disiplinor të paditurës - Organi Punëdhënës Qendra Korrektuese në Dubravë – Ministria e Drejtësisë me nr. protokollit, 115, i datës: 18.07.2008, respektivisht e gjithë procedura është kryer, para hyrjes në fuqi me dt. 11.07.2010, të Ligjit të Shërbyesit Civil nr. 03-L-149, të cilit i referohet e autorizuar e paditësit, andaj edhe nuk ka mundur të thirret në aplikimin e këtyre dispozitave.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim

të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të cekura në ankesë nga paditësi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, dispozitivi i aktvendimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për palejshmërinë e padisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jokontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës i aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, me dt. 28.09.1989 në vend që të aplikohet Ligji mbi Punën e Bashkuar, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988 bazuar edhe e Qëndrimin Parimor të Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. protokollit GJ.A.Su.A. 231/2022, të datës 07.11.2022, mirëpo meqenëse afatshmeria e padisë së paditësit me të cilin ka kërkuar mbrojtje gjyqësore nuk është respektuar nga ana e paditësit edhe sipas dispozitave të Ligjit 1989 dhe 1988 gjykata e Apelit mbi këtë bazë e pranoi si të ligjshme vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë:

Lidhur me afatshmërinë e padisë në kontestet nga marrëdhënia e punës lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës, përfshirë ndërprerjen e marrëdhënies së punës, apo ndryshimit të vendit të punës, apo çfarëdo të drejte tjetër lidhur me statusin e punëtorit nga marrëdhënia e punës, duhet që gjykata të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse kërkesa është ushtruar konform dispozitave të nenit 178 paragrafi 1, 179 paragrafi 1 dhe 181 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988.

Gjykata e Apelit, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesë, mirëpo të njëjta janë të pabazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 178 paragrafi 1, 179 paragrafi 1 dhe 181 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, janë afate prekluzive, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, në rast të kalimit, padia është gjithmonë e pasafatshme, pa marrë parasysh arsyet e lëshimit të afatit.

Me nenin 391 paragrafi 1 pika f) e LPK-së, përcaktohet se: “ Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejshme, po që se konstaton se:... padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj ”.

Me nenin 178 paragrafi 1 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përcaktohet se: “ Kërkesën për mbrojtje të së drejtës punëtori i paraqet organit të caktuar me statut të organizatës, në afat prej 15 dite, nga dita kur ka kuptuar shkeljen e të drejtës, respektivisht nga dita kur i është dorëzuar vendimi me të cilin i është shkelur një e drejtë e tij ”.

Me neni 179 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se “ Organi kompetent në organizatë është i detyruar që sipas kërkesës së punëtorit të merr vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës ”.

Me nenin 181 paragraf 1 të këtij ligji, përcaktohet se: ” Nëse punëtori është i pakënaqur me vendim, apo nëse organi kompetent në organizatë nuk merr vendim në afat prej 15 dite nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë që në afatin tjetër prej 15 dite të kërkojë mbrojtjen e të drejtës në gjykatë”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se “ Mbrojtjen e të drejtës në gjykatë nuk mund ta kërkojë punëtori i cili paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtje të së drejtës tek organi kompetent në organizatë ”.

Me Qëndrimin Parimor të Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. protokollit GJ.A.Su.A. 231/2022, të datës 07.11.2022 është përcaktuar se: “ Në kontestet e punës, në të cilat punëtorit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkelje të detyrave të punës, në bazë të Rregullores së UNIMIK-ut, nr.2001/27 të datës 8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, përkitazi me çështjen e fillimit, zhvillimit dhe përfundimit të procedurës disiplinore, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës të Jugosllavisë i vitit 1977 me amendamentet përkatëse, dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të KSA të Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 24/22 qershor 1984), dhe Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr. 14/1987 datë 24 prill 1987) e as dispozitat e Ligjit të mëvonshëm për Marrëdhëniet e Punës i KSA të Kosovës - Gazeta Zyrtare nr. 12/1989 datë 14 prill 1989, i cili nuk ishte në fuqi më datën 22 mars 1989, në të cilën datë referon Rregullorja e UNIMIK-ut, 1999/24, datë 12 dhjetor 1999 e cila në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj të zbatueshëm në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Mirëpo në rastet e tilla të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së detyrave të punës, nëse tek punëdhënësi me rregullore të brendshme parashihet zhvillimi i procedurës disiplinore, ata punëdhënës janë të obliguar që t’i respektojnë dhe zbatojnë këto rregullore përkitazi me procedurën disiplinore. Lidhur me afatshmërinë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore e cila çështje nuk është e rregulluar me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2001/27 të datës 8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, do duhej zbatuar neni 178, 179 dhe 181 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 11/1988 datë 10 shkurt 1988 ku parashihet ankimimi intern brenda organeve të punëdhënësit dhe në gjykatë, si dhe afatshmëria e kërimit të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës tek punëdhënësi dhe në gjykatë ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton se palët për të fituar të drejtën për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht të plotësohen në mënyrë komulative dy parakushte procedurale dhe atë: a) punëtori paraprakisht ti ketë shterur procedurat interne (mjetet e brendshme) për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe b) që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se padia a është paraqitur në gjykatë në afatin e paraparë ligjorë (lejueshmërinë e padisë në kuptim të dispozitave ligjore të cekura me lartë).

Afati për paraqitjen e padisë është prezumim procedural nga i cili varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, e për të cilin prezumim gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, por që sipas dispozitave të LPK-së, vjen në shprehje vetëm në rastet kur me dispozita ligjore përcaktohet në mënyrë specifike se mbrojtja gjyqësore mund të kërkohej vetëm brenda afateve të caktuara, siç është rasti në kontestet e punës dhe pengim posedimit, etj.

Hedhja poshtë e padisë për shkak të afatit nënkupton situatën kur gjykata e ka vlerësuar se procesi gjyqësorë është i palejueshëm për shkak se nuk plotësohen kushtet respektivisht prezumimet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësorë. Hedhja e padisë mund të bëhet për shkak të pengesave procedurale që lidhen me gjykatën - kompetencën, palët - cilësinë e palëve dhe përfaqësimin, objektin e kontestit si: çështja e gjykuar, litispendenca, ekzistimi i ujdisë gjyqësore, ekzistimi i vendimit mbi heqjen dorë nga kërkesëpafia apo edhe mungesa e interesit juridik dhe po ashtu mund të hedhet për shkak të parregullsisë formale të padisë nëse edhe pas kërkesës për plotësimin e padisë pala dorëzon parashtrësën e pa plotësuar, si dhe në rastin e pengimit të posedimit dhe kontesteve të punës nëse nuk është parashtruar brenda afati ligjor. Ndërsa për prapësimet e natyrës materiale gjykata vendos në mënyrë meritore. Për të vendosur për prapësimin e natyrës materiale - juridike, gjykata duhet të theksoj rrethanat faktike që lidhen me të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, natyrën e kërkesave dhe pas

vlerësimit të këtyre rrethanave gjykata duhet të vendosë me aktgjykim për besueshmërinë e kërkesëpadisë.

Në këtë rast në kuptim të afatit që përcaktohet me dispozitat e cekura më lartë, rrjedhë se padia e paditësit për anulim të vendimit të datës 28.02.2008, është e pa lejuar - gjegjësisht e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë në gjykatën e shkallës së parë, nëpërmes e ka paraqitur me datë 13.07.2015, nga rrjedh se prej datës kur e paditura ka marr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar mbi 8 vite.

Në kuptim të arsyeve të paraqitura në arsyetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe vlerësimeve të sipër theksuara, Gjykata e apelit, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet sipas ankesës për arsye se gjykata e shkallës së parë dhe as kjo gjykatë nuk kanë mundur ta vlerësojnë ligjshmërinë e vendimit për largimin nga puna të paditësit, për shkak se padia ka qenë e pasafatshme/e palejuar. Afatëshmëria e padisë është prezumim procedural nga i cili varet lejueshmëria e procesit gjyqësor (lejueshmëria e padisë) dhe në mungesë të plotësisht të këtij prezumimi gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat si më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3171/2021, me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v